

**AKT THEMELIMI DHE STATUTI
I SHOQËRISË ME PËRGJEGJËSI TË KUFIZUAR
“Circle”SHPK**

**KREU I
Dispozita te Pergjithshme**

Sot, në datën 05 / 09 /2023 (dymije e njezete e tre) personat e me poshtem:

1. **Z.Geri POGONI**, atesia Kristo, i datelindjes 26.02.1987, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, shtetas Shqiptar, madhor e me zotesine e pote per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit me nr. Personal I70226075K;
2. **Znj. Angela VATA**, atesia Xhetan, i datelindjes 11.09.1996, lindur ne Tirane, banues ne Tirane, shtetase Shqiptare, madhor, me zotësi te pote për të vepruar, mbajtes i Pasaportes nr. personal J65911072L;
3. **Z.Mikail HOXHA**, atesia Xhevít, i datelindjes 06.03.2004, lindur ne Tirane, banues ne Tirane, shtetas Shqiptar, madhor e me zotesine e pote per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit me nr. Personal K40306050T;

ne cilesine e "Ortakëve Themelues", me vullnet te lire te pote e te sinqerte, dhe inisiativen e lire private, mbeshtetur ne Kushtetuten e Republikës se Shqipërisë, Kodin Civil ne fuqi, ligjin Nr. 9901 date 04.04.2008, "Per Tregtaret dhe Shoqerite tregtare" dhe ligjin Nr. 9723, date 03.05.2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit", te ndryshuarvendosen te themelojne shoqerine tregtare, me perjegjesi te kufizuar, me emertimin "**Circle**" SHPK.

**KREU II
Ortaket, Emri, Objekti, Kohëzgjatja dhe Zyra Qendrore**

Neni 1

Emri dhe Ortaket

- 1.1 Shoqeria eshte e organizuar dhe funksionon sipas formes "shoqeri me perjegjesi te kufizuar" dhe mban emrin "**Circle**" SHPK.
- 1.2 Kapitali i shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar ndahet në një numër kuotash, në raport me kontributin e dhënë nga çdo ortak në shoqëri. Çdo ortak zotëron një kuotë të vetme në shoqëri.

Neni 2

Objekti

Shoqeria "**Circle**" SHPK do te kete objekt veprimtarie:

Ne fushen e administrimit te hoteleve dhe airbnb, marketingun e tyre, krijimin e faqeve web dhe administrimin e tyre si edhe konsulencë, etj.

Neni 3

Kohëzgjatja

- 3.1 Shoqeria do te ushtroje aktivitetin e saj per një afat te pakufizuar, me perjashtim te rastit kur Asambleja e Ortakeve, sipas kuorumit perkates vendos ndryshe.
- 3.2 Shoqeria "**Circle**" SHPK gezon statusin e personit juridik shqiptar nga momenti i regjistrimit si e tille ne regjistrin tregtar te QKB-se.

Neni 4

Zyra Qendrore

- 4.1 Zyra qendrore e shoqërisë ndodhet ne adresën:**Tirane,Njesia administrative nr.5 Rruga Ibrahim Rrugova,Ndertesa 28,Nr. Pasurie 3/16+1 – N8.**
- 4.2 Gjate veprimtarise se saj, shoqeria ka te drejte te krijoje dhe hape dege, filiale dhe/ose zyra perfaqesimi edhe ne qytete te tjera, brenda dhe/ose jashte territorit te Republikes se Shqiperise, ne perputhje me legjislacionin e kerkuar ne fuqi sipas juridiksonit te vendit perkates.
- 4.3 Personi i kontaktit prane shoqerise do te jete Z.Geri POGONI me te dhenat si me poshte:
-geri.pogoni@gmail.com
-nr cel: 069 20 44 581

KREU III

Neni 5

Vlera dhe pagesat e kapitalit te regjistruar

- 5.1 Kapitali i regjistruar i shoqerise është **500.000Lek**(peseqind mijë leke), i barabarte me 3 (tre) kuota. Kontributet e ortakeve perbejne kapitalin e regjistruar te shoqerise.
- 5.2 Pjesëmarria e Ortakut në kapitalin e shoqërisë eshte ne raport me kontributin e derdhur prej tij dhe vlera nominale e kuotes te seicilit ortak, llogaritet ne raport me seicilin kontribut, e paraqitur ne menyre te permbledhur sipas grafikut te meposhtem:

Nr.	Emri i Ortakeve	Kuota	Kontributi i ortakeve ne kapital (leke)	Perqindja ne kapital
1.	Z. Geri POGONI	1	300.000	60 %
2.	Znj. Angela VATA	1	150.000	30 %
3.	Z.Mikail HOXHA	1	50.000	10 %
Totali		3	500.000	100 %

- 5.3 Kontributet sa me siper jane nenshkruar dhe shlyer plotesisht nga ana e ortakeve te shoqerise.

Neni 6

Zmadhimi dhe Zvogëlimi i Kapitalit Themeltar

- 6.1 Asambleja e Përgjithshme, me shumicë të kualifikuar, mund të zmadhojë kapitalin themeltar të shoqërisë duke rritur kuotat e ortakëve ekzistues në shumën e përcaktuar në vendimin përkatës. Zmadhimi i kapitalit me qëllim pranimin e ortakëve të rinx në shoqëri, miratohet nga Asambleja e Përgjithshme me shumicën e kualifikuar (tre të katërtat) të votave të ortakëvenë përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit.

- 6.2 Shoqëria mund të vendosë zvogëlimin e kapitalit themeltar te shoqërisë me vendimin e Asamblesë së Përgjithshme, të marrë me shumicën e kualifikuar të votave (tre të katërtat) në përputhje me parashikimet e nenit 87 të Ligjit, duke pasur parasysh qe te respektohet minimumi i parashikuar nga Ligji për Shoqerite Tregtare.

KREU IV

Neni 7

Kuotat dhe Kalimi i Kuotave

- 7.1 Kontrata e kalimit të kuotës bëhet me shkrim ndermjet paleve.
- 7.2 Transferimi i kuotave te ortakeve te shoqerise ne drejtim te personave te trete jashte ortakerise eshte i kushtezuar ne cdo rast nga ushtrimi i te drejtës se parablerjes ne favor te ortakeve ekzistues.

Ortaku, para se t'i transferoje ne cdo forme kuotat e veta nje personi te trete jashte saj, detyrohet të njoftojë me shkrim paraprakisht te gjithe ortaket ekzistues në se dëshirojnë të blejnë kuotat me të njëjtat kushte ekonomike si dhe ne menyre perpjektimore sipas kuotave qe zoterojne ne kapital te shoqerise.

Në rast se te gjithe ortaket nuk përgjigjen me shkrim brenda 20 diteve nga njoftimi apo deklarojne se nuk dëshirojnë të blejnë kuotat, ortaku është i lire të transferoj kuotat e tij teresisht apo pjeserisht në drejtim te personave te trete jashte ortakerise.

Në rast se nje pjese e ortakeve ekzistues përgjigjen me shkrim brenda 20 diteve dhe deklarojne se dëshirojnë të blejnë kuotat, ortaku është i detyruar ti transferoj kuotat e tij në drejtim te tyre ne menyre te barabarte (dmth ne rast se dy ortaksh shprehin deshiren per blerjen e kuotave, ato do tu shiten te dy ortakeve ne menyre te barabarte, pra 50% seicilit).

Neni 8

Kalimi i kuotave me Trashëgimi ose si pasojë e Falimentimit

- 8.1 Nëse një ortak vdes, trashëgimtarët në rastin e bashkëzotërimit të kuotave, dhe trashëgimtarët e tij në rast se ky person ishte zotërues ose trashëgimtar i vetëm i bashkëzotëruves të kuotave, do tëjenë personat e vetëm të njohur nga shoqëria si gjëzues së të drejtave mbi kuotën e tij; pavarësisht parashikimeve të këtij Statuti, pasuria e ortakut të vdekur nuk çlirohet nga përgjegjësia në lidhje me kuotën e zotëruar nga ai vetëm apo së bashku me persona të tjera.
- 8.2 Personi që fiton të drejtën mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku, pas paraqitjes së provave të kërkuan nga Administratori, mund të zgjedhë të bëhet zotërues i kuotës ose të kërkojë regjistrimin e kuotës në emër të një personi tjetër te caktuar prej tij si përfitues të kuotës. Nëse personi i mësipërm zgjedh të bëhet zotërues i kuotës, ai njofton shoqërinë në lidhje me këtë zgjedhje. Nëse ky person zgjedh që një person tjetër të regjistrohet si zotërues i kuotës, ai kalon kuotën në dobi të personit tjetër.
- 8.3 Personi që fiton të drejta mbi një kuotë si pasojë e vdekjes ose falimentimit të një ortaku do të ketë të drejtat që gjëzonte zotëruesi i kuotës, duke përjashtuar të drejtën e pjesëmarrjes ose të votës në çdo mbledhje të Asamblesë së Përgjithshme, deri në momentin e regjistrimit ne QKB.

3

Kreu IV
Asambleja e Përgjithshme

Neni 9

Kompetencat dhe Thirrja e Asamblese se Pergjithshme

- 9.1** Asambleja e Pergjithshme eshte organi me i larte vendimarres i Shoqerise. Asambleja e Pergjithshme do te vendose, por pa u kufizuar, per çeshtjet e meposhtme te Shoqerise:
- a. percaktimi i politikave tregtare;
 - b. ndryshime te Statutit;
 - c. emerimi dhe shkarkimi i administratorit/administratoreve;
 - d. emerimi dhe shkarkimi i likuiduesve dhe i eksperteve kontabel te autorizuar;
 - e. miratimi i skemes se shperblimeve per personat e permendur ne shkronjat c. dhe d.;
 - f. mbikeqyrja e zbatimit te politikave tregtare nga ana e administratorit/administratoreve, duke perfshire perqatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
 - g. miratimi i pasqyrave financiare vjetore dhe i raporteve mbi ecurine e aktivitetit te Shoqerise;
 - h. zmadhimi ose zvogelimi i kapitalit;
 - i. pjesetimi i kuotave dhe anulimi i tyre;
 - j. perfaqesimin e shoqerise ne gjykime dhe ne procedime te tjera kunder administratorit/administratoreve te saj;
 - l. riorganizimi dhe prishja e Shoqerise;
 - m. miratimi i rregullave procedurale te mbledhjeve te saj;
 - n. çeshtje te tjera te parashikuara nga Ligi per Shoqerite Tregtare dhe Statuti.

Nëse shoqëria mbetet me një ortak, atëherë ortaku i vetëm detyrohet ta regjistrojë këtë fakt, sipas nenit 43, të ligjit nr. 9723, datë 3.5.2007, "Për Qendrën Kombëtare të Biznesit";, të ndryshuar. Nëse ortaku i mbetur nuk përmbush këtë detyrim, atëherë ortaku përgjigjet personalisht për detyrimet që shoqëria merr përsipër nga data në të cilën duhet të ishte kryerregistrimi, sipas këtij neni, deri në datën në të cilën ky regjistrim u krye efektivisht"

- 9.2** Asambleja e Pergjithshme merr vendime per ceshtjet e permendura ne pikat (g) dhe (h) me siper pas shqyrtimit te dokumentacionit perkates te derguar me thirrjen e mbledhjes se asamblese se pergjithshme.
- 9.3** Mbledhja e Asamblesë së Përgjithshme thirret nga administratori apo ortaket e minorances sipas dispozitave te ligjit per shoqerite tregtare ne fuqi nëpërmjet një njoftimi me shkrese, me postë ose e -mail drejtuar çdo ortaku, përfshirë edhe përfaqësuesin e kuotave në zotërim të përbashkët. Njoftimi duhet të kryhet të paktën 7 (shtatë) ditë të plota përparrë datës së caktuar për mbledhjen përvëç rasteve kur njoftimi i mbledhjes së

- Asamblesë së Përgjithshme i cili përmban një afat më të shkurtërështë miratuar nga te gjithe ortaket qe zoterojne 100% te kapitalit te shoqerise.
- 9.4** Njoftimi per thirrjen e Asamblese duhet te permaje ne menyre te qarte daten, diten, kohen, vandin dhe rendin e dites te mbledhjes, se bashku me dokumentacionin perkates dhe do t'u dergohen te gjithe Ortakeve te Shoqerise te pakten 7 (shtate) dite perpara mbledhjes.

Ne rast ndryshimi te rendit te dites, do te ndiqet e njejtja procedure njoftimi qe pershkruhet me siper.

Neni 10

Kuorumi i nevojsphem

- 10.1** Në rastin e marrjes së vendimeve, që kërkojnë një shumicë të zakonshme, asambleja e përgjithshme mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë jo me pak se 75 për qind të kapitalit te shoqerise.
- 10.2** Në rastin kur asambleja e përgjithshme duhet të vendosë për çështje, të cilat kërkojnë shumicë të kualifikuar sipas nenit 87 të ligjit "Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare", ajo mund të marrë vendime të vlefshme vetëm nëse marrin pjesë ortakët me të drejtë vote, që zoterojnë jo me pak se 75 për qind të kapitalit te shoqerise.
- 10.3** Nëse asambleja e përgjithshme nuk mund të mblidhet për shkak të mungesës së kuorumit të përmendur me lart, asambleja mblidhet përsëri jo më vonë se 30 ditë, me të njëjtin rend dite.

Neni 11

Marrja e vendimeve

- 11.1** Asambleja e Ortakeve vodos me 3/4 të ortakëve zoterues te kapitalit te shoqerise me te drejte vote, për çeshtje te rendesishme qe kane te bejne me ndryshimin e statutit, zmadhimin ose zvogëlimin e kapitalit të regjistruar, shpërndarjen e fitimeve, riorganizimin dhe prishjen e shoqërisë etj.
- 11.2** Asambleja e përgjithshme vodos me shumicën e thjeshte te votave të ortakëve pjesëmarrës, për çeshtje te tjera te zakonshme si :
- a) përcaktimi i politikave tregtare të shoqërisë;
 - b) emërimin dhe shkarkimin e administratorëve;
 - c) emërimin e shkarkimin i likuiduesve dhe të ekspertëve kontabël të autorizuar;
 - ç) përcaktimin e shpërblimeve;
 - d) mbikëqyrjen e zbatimit të politikave tregtare nga administratorët, përfshire përgatitjen e pasqyrave financiare vjetore dhe të raporteve të ecurisë se veprimtarisë;
 - e) përfaqësimin e shoqërisë në gjykatë dhe në procedimet e tjera ndaj administratorëve;
 - f) miratimin e rregullave procedurale të mbledhjeve të asamblesë;
- 11.3** Ortaku mund të përfaqësohet në asamblenë e përgjithshme, në bazë të një autorizimi nga një ortak tjetër apo nga një person i tretë.
Administratorët e shoqërisë nuk mund të veprojnë si përfaqësues të ortakëve në asamblenë e përgjithshme.
Autorizimijepetnëformëshkresorevetëmpërnjëmbledhjetëasamblesësëpërgjithshmedheështëivlefshëmedhepërbledhjetvijuese me tënëjtin rend

5

dite.

- 11.4** Kryetari i mbledhjes se asamblese se per gjithshme do te jetë administrator i shoqerise i cili do te drejtoje mbledhjen dhe asambleja e per gjithshme ne cdo mbledhje te saj do te emeroje me shumice te thjeshte te votave te ortakeve pjesemarres edhe një person tjeter për të mbajtur proces-verbalin e mbledhjes se asamblese se per gjithshme.
- 11.5** Çdo vendim i mbledhjes se asamblese se per gjithshme do te regjistrohet ne proces-verbal, i cili do te mbahet ne perputhje me nenin 90 te ligjit Per Tregtaret dhe Shoqerite Tregtare.

Neni 12

Votat e Ortakëve

- 12.1** Çdo ortak ka të drejta vote në përpjesëtim me vlerën nominale të kuotës së tij. Bashkëzotërueshit e një kuote ushtrojnë të drejtat e votes bashkërisht, sipas nenit 72 të ligjit per shoqerite tregtare ne fuqi.
- 12.2** Asnjë ortak nuk do të votojë në mbledhjen e Asamblesë së Përgjithshme, personalisht ose nëpërmjet përfaqësuesve, në lidhje me kuotën e zotëruar prej tij, nëse nuk ka shlyer tërësisht detyrimet që kanë të bëjnë me këtë kuotë.

Kreu V Administratori

Neni 13

Emërimi i Administratorit

- 13.1** Asambleja e Përgjithshme zgjedh një ose më shume persona fizikë si Administratorë të shoqërisë për një periudhë pesëvjeçare, në pajtim me parashikimet e shkronjës "c" të pikës 1 të nenit 81 dhe nenit 95 të Ligjit. Emërimet do të jenë individuale dhe sipas një vendimi të marrë me shumicën e votave te ortakeve ne Asambleja e Përgjithshme, i cili, nëse miratohet, sjell emërimin e personit të propozuar si Administrator.
- 13.2** Personi i mëposhtëm caktohet si Administrator i shoqërisë "Circle" SHPK:
Z. Geri POGONI, atesia Kristo, i datelindjes 26.02.1987, lindur ne Tirane dhe banues ne Tirane, shtetas Shqiptar, madhor e me zotesine e plote per te vepruar, mbajtes i Leternjoftimit me nr. Personal I70226075K, **per nje afat 5 vjecar, nga momenti i regjistrimit te ketij fakti prane Qendres Kombetare te Biznesit.**

Neni 14

Kompetencat e Administratorit

- 14.1** Politikat tregtare të shoqërisë si dhe aktiviteti normal i saj do të administrohen nga Administratori i cili mund të ushtrojë të gjithë kompetencat që nuk i rezervohen Asamblesë së Përgjithshme sa me siper dhe ligjit tregtar ne fuqi.
- 14.2** Pa u kufizuar sa me siper, ne menyre te vecante, Administratori ka keto kompetencat:
- (i) do te drejtoje dhe te perfaqesoje Shoqerine persa i perket administrimit te zakonshem;
 - (ii) do te nenshkrueje cdo marreveshje ne emer te Shoqerise;
 - (iii) do te hape llogari ne emer te Shoqerise me cdo banke ose kryen aktivitet ne Shqiperi ose jashtë saj,

- (iv) do te pergatise te gjitha planet per marrjen e financimeve, do te nenshkruaje cdo kontrate huaje apo kontrate tjeter qe parashikon nje borxh apo borxh te mundshem per Shoqerine, hipoteke, peng apo cdo marreveshje tjeter qe krijon apo mund te krijoje nje barre mbi pasurite e Shoquerise, marreveshje garancie, kontrate per shitjen e pasurive te paluajtshme apo te luajtshme te Shoquerise. Te gjitha veprimet e parashikuara ketu (pika iv) do te jene te vlefshme nese jane te autorizuara shprehimisht me ane te nje Vendimi te Asamblese se Pergjithshme te marre me shumice unanime;
- (v) do te urdheroje dhe kryeje pagesa ne emer te Shoquerise – duke nenshkruar dokumentet / instrumentet e pagesave;
- (vi) do te kujdeset per mbajtjen e sakte e te rregullt te dokumenteve dhe te librave kontabel te Shoquerise;
- (vii) do te pergatise dhe nenshkruaje bilancin vjetor, bilancin e konsoliduar dhe raportin e ecurise se veprimtarise dhe, se bashku me propozimet per shperndarjen e fitimeve, ia paraqet per miratim Asamblese se Pergjithshme;
- (viii) do te krijoje nje sistem monitorimi dhe paralajmerimi njoftimi te hershem per rrethanat qe kercenojne ekzistencen e Shoquerise;
- (ix) do te kryeje regjistrimet e publikimet e detyrueshme te te dhenave te Shoquerise, sipas kerkesave te Ligjit nr. 9723, date 3 Maj 2007 "Per Qendren Kombetare te Biznesit";
- (x) do t'i raportoje Asamblese se Pergjithshme per zbatimin e politikave tregtare dhe per realizimin e veprimeve me rendesi te vecante per veprimtarine e Shoquerise;
- (xi) do te marre ne pune, emeroje, shkarkoje te punesuar te Shoquerise per cdo nivel, perfshire edhe te punesuar me kohe te pjesshme, konsulente, agjente, do te percaktoje kompetencat dhe detyrat e tyre, si dhe do te percaktoje shperblimin e tyre;
- (xii) te kryeje detyra te tjera, te percaktuara ne Ligjin per Shoquerite Tregtare, duke pasur parasysh respektimin ne cdo rast te kufizimeve te parashikuara nga ky Statut, si dhe detyrat e dhena me Vendim te Asamblese se Pergjithshme.

Asambleja e përgjithshme, në bazë të një vendimi të marrë me shumicën e përcaktuar sa me siper, ka të drejtë të ngrejë padi përparrë gjykates kompetente pér shfuqizimin e vendimeve të administratorëve, si pasojë e shkeljes së rëndë të ligjit ose të statutit dhe/ose paditë tjera që parashikon ky ligj ose statuti ndaj administratorëve apo ortakëve.

Neni 15

Skualifikimi dhe Shkarkimi i Administratorit

Detyra e Administratorit përfundon në rast se:

1. personi nuk është më Administrator sipas parashikimeve të Ligjit përfshirë edhe parashikimet e pikës 6 të nenit 95 të Ligjit;
2. personi vuani ose mund të vuajë nga çrrëgullime mendore;
3. ndodhet ose mund te ndodhet ne kushtet e pa-aftesise fizike;
4. jep doreheqje nga detyra duke njoftuar shoquerine;
5. vdekjeje;
6. ndodhet ne situata apo rrethana te cilat e bejne te pamundur ushtrimin e detyrave te tij;

Neni 16

Kufizimet në Veprimet e Administratorit

- 16.1** Administratori nuk do të lidh marrëveshje për çeshtje në të cilin ai ka, direkt ose indirekt, një interes apo detyrim i cili është material, që është apo mund të jetë në kundërshtim me interesat e shoqërisë, në pajtim me nenin 13 të Ligjit per shoqerite tregtare, deri në momentin kur Asambleja e Përgjithshme e shoqerie, ne baze te kuorumi te kerkuar, autorizo lidhjen e kësaj marrëveshje.
- 16.2** Autorizimi mund të jetë i përgjithshëm ose i posaçëm për një çeshtje të caktuar. Autorizimi i përgjithshëm duhet të regjistrohet pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

Kreu VI Prishja dhe njoftimet

Neni 17

17.1 Shkaqet e prishjes së shoqërisë

Shoqëria me përgjegjësi të kufizuar prishet:

- a) kur mbaron kohëzgjatja, për të cilën është themeluar;
- b) me përfundimin e procedurave të falimentimit apo në rast të pamjaftueshmërisë së pasurive për të mbuluar shpenzimet e procedures së falimentimit;
- c) në rast se objekti bëhet i parealizueshëm për shkak të mosfunkcionimit të vazhduar të organeve të shoqërisë apo për shkaqe të tjera që e bëjnë absolutisht të pamundur vazhdimin e veprimtarisë tregtare;
- ç) në rastet e pavlefshmërisë së themelimit të shoqërisë, të parashikuara nga neni 3/1 te ligjit per shoqerite tregtare;
- d) në raste të tjera, të parashikuara në statut;
- dh) në raste të tjera, të parashikuara me lig;
- e) për çdo shkak tjetër të vendosur nga asambleja e ortakëve.

17.2 Në rast të likuidimit të shoqërisë, likuiduesi, në përputhje me Ligjin dhe me vendimin e marrë me shumicën e kualifikuar së votave të Asamblesë së Përgjithshme, mund të shpërndajë në dobi të ortakëve të gjithë ose një pjesë të vlerës së pasurive të shoqërisë dhe për këtë qëllim, mund të vlerësojë çdo pasuri dhe të përcaktojë mënyrën e shpërndarjes midis ortakëve të shoqërisë.

17.3 Administratori eshte i detyruar të regjistrojë prishjen e Shoqërisë në QKB, me perjashtim te rastit kur prishja bëhet me vendim gjykate; ne kete rast eshte gjykata qe i dergon njoftimin QKB-se.

Neni 18

Njoftimet

18.1 Njoftimet e kryera nga çdo person sipas parashikimeve të Statutit, duhet të jenë me shkrim ose (nëse zbatohet) nëpërmjet komunikimit elektronik në adresën e parashikuar sipas pikës 3 të nenit 4 të këtij Statuti dhe janë të vlefshme në lidhje me kohën e njoftuar për këtë qëllim dhe personin që kryen njoftimin.

8

- 18.2** Shoqëria mund të njoftojë një ortak personalisht ose duke e dërguar njoftimin me letër porosi me kthim përgjigje në adresën e regjistruar të ortakut ose në adresën apo postën elektronike (nëse ka) që i është njoftuar shoqërisë nga ortaku. Kur ka disa bashkëzotërues të një kuote, të gjitha njoftimet i jepen përfaqësuesit të tyre të përbashkët në përputhje me pikën 2 të nenin 72 të Ligjit.

Neni 19

Te Ndryshme

- 19.1** Cdo dokument qe leshohet per dhe ne emer te shoqerise eshte i pavlefshem nese nuk mban vulen e saj.
- 19.2** Te gjitha marredheniet e punes ne shoqeri rregullohen me Kodin e Punës dhe cdo akt tjeter ligor dhe nenligor te zbatueshem te Republikës se Shqiperise, ne fuqi dhe ne veprim kohe pas kohe gjate periudhes se ushtrimit te aktivitetit te saj tregtar.
- 19.3** Viti finanziar zgjat 12 (dymbedhjete) muaj, duke filluar më 1 Janar dhe mbaron më 31 Dhjetor të cdo viti.
- 19.4** Ne fund te cdo viti finanziar, Administratori harton bilancin vjetor dhe raportin e administrimit, te cilet i dergohen per miratin Asamblese se zakonshme.
- 19.5** Per te gjitha ceshtjet qe nuk jane parashikuar ne kete Statut, do te zbatohen parashikimet e Ligjit per Shoqerite Tregtare ne fuqi, te azhornuar.

NENI 20

Dispozita perfundimtare

- 20.1** Ky statut perben dokumentin e vetem te shoqerise qe parashikon themelimin dhe organizimin e veprimtarise se shoqerise. Ky Statut mund te ndryshohet, rishikohet dhe/ose shfuqizohet pjeserisht ose teresisht dhe te zevendeshet me një statut te ri vetem me vendim te Asamblese se Pergjithshme te Ortakeve sipas shumices se cilesuar te percaktuar me siper.
- 20.2** Per sa nuk eshte parashikuar ne kete statut, ortaket do ti referohen legjislacionit tregtar Shqiptar ne fuqi si dhe praktikave tregtare ne vend.


Ky statut u redaktua ne 4 ekzemplare, me permbajtje dhe vlera te njejtë juridike, ne gjuhen Shqip dhe u nenshkrua nga ortaku themelues pa asnje rezerve.

ORTAKËT THEMELUESTE SHOQERISE

Z. Geri POGONI



Znj. Angela VATA



Z.Mikail HOXHA

